



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.773/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit S. B. nga fshati B. K. L., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.6536/17 të dt.03.11.2017, për shkak të veprës penale Vjedhje shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në shqyrtimin e dytë gjyqësor publik, të bajtur me dt.19.10.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit R. L., dhe të pandehurit, në të njëjtën datë merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

S. B., i biri i I. dhe H., i lindur me datën *data e lindjes...*, në fshatin B. Komuna L., ku e ka edhe vendbanimin, me nr. personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 17.08.2017, në shtëpinë e tij në në fshatin B. Komuna L., i pandehuri S. B., me qëllim që vetit t'i sjellë pasuri të kundërligjshme, ka keqpërdorur energjinë elektrike pa autorizim të furnizuesit të autorizuar KEDES-it, ka keqpërdorur energjinë elektrike ku nëpërmes një lidhje direkte me anë të një kablllo jashtë pikës matëse, ka anashkaluar njehsorin elektrik dhe është furnizuar me energji elektrike me çka energjia elektrike nuk është regjistruar fare, me këtë të dëmtuarës KEDS-it i ka shkaktuar dëm në vlerë prje 217.14-€ euro,-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata, konform neneve 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, dhe nenit 320 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me,

DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale

Me dënim me gjobë në shumë prej 100-€ (njëqindeuro), të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 46 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i pandehuri, që të dëmtuarës KEDS-it në Ferizaj t'ia kompensoj shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 217.14-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të i'a paguajnë shumën prej 20-€, si dhe shumën prej 30-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr. 7308/16 të dt. 06.03.2017, e ka akuzuar të pandehurin B. B., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Në shqyrtimin e dytë gjyqësor përfaqësuesi i Prokurorisë ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore, me vullnet dhe pa presion, e në përputhje me provat dhe shkresat të cilat janë bashkangjitur lëndës, andaj i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta pranojë dhe njëherit të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin e dytë gjyqësor, pasi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, ka deklaruar se e ndjen vetën fajtor për veprën penale që i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se është mbajtës i familjes 6 antarshe, hera e parë që ka rënë ndeshë me ligjin, dhe i njëjti i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën të tillë penale dhe ka propozuar që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes se llojit të dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin konform nenin 73 të KPRK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen para kryrjes së veprës penale të t' pandehurit, pra për faktin se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e pergjigjësisë penale të t' pandehurit, pra faktin se i njëjti ka qenë plotësisht i aftë dhe i vetëdijshëm që t'i kuptoj sjelljet dhe veprimet e tija dhe duke marrur për bazë shkallën e rrezikshmerisë së veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë i bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale u bazua në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 6 të KPPK-së, ndërsa detyrimi për pagesën në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave u bazua në nenin 39 të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike gjithashtu u bazua në dispozitivin e nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr.773/17 dt.19.10.2018

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.